

## **Imam Aliu në misionin e tij kishte program pune të drejtat e njeriut**

I dërguari i Allahut, paqja e bekimi i Zotit qoftë mbi të, rriti krenarinë e popullit arab. Zëri i tij i butë dhe i ëmbël thërriste: "Arabi nuk ka përparësi ndaj jo arabit veçse me devotshmëri dhe njeriu është vëlla për njeriun, e do ose e urren". Thirrja për vllazërim njerëzor, ishte barazia e njerëzve në të drejtat e tyre. Në këtë zë bënte pjesë edhe thirrja për çlirimin e gruas nga dhuna e burrit, çlirimi i skllavit, punëtorit nga poshtërimi i punëdhënësit, ishte zëri i një revolucioni për shoqërinë. Krahas të dërguarit të Zotit e pas tij këtë zë e shoqëroi dhe e drejtoi Ali Bin Ebu Tolib për të cilin Shibli Shumaj thotë: "Imam Ali bin Ebu Talibi, i madhi i të mëdhenjëve, hapja e vetme. Si kjo figurë nuk kishte parë as Lindja as Perëndimi, nuk ishte parë as në kohët e herëshme e as do të shihet më vonë. Figurë plotësisht origjinale". Kjo figurë qëndroi në krye të historisë për shekuj me radhë deri në ditët e sotme. Ai solli mendime të reja mbi jetën dhe vdekjen, ligje te reja në legjislacione, në sistemet, në kushtetutat, në ligjet morale për bashkësinë njerëzore, bashkëpunimin e njeriut me njeriun në një shoqëri, për të gjithë me të drejta të barabarta. Ato ishin vlera që la trashëgim për të parët e pastaj ata i trashëgojnë tek pasardhësit.

Ali bin Ebu Talibi shquhej për zgjuarësinë e rrallë, i apasionuar në zbulime e shpjegime, i përqëndruar mbi rregullat e ligjet, i thelluar në kuptimin e tyre, depërtues deri në më të zakonshmet që të mos mbeteshin të panjohura për njerëzit. Mendimi i tij prej kolosi depërtoi thellë në rrënjët e shoqërisë, zbuloi të vërtetën e saj, atë të vërtetë për të cilën shprehet: "Nuk ka ndonjë të uritur të varfër, përveç se prej asaj me të cilën kënaqet i pasuri"; ose "Nuk kam parë ndonjë me bollëk të madh dhe që pranë tij të mos jetë një e drejtë e humbur". Ky ishte Imam Aliu i cili prej dhjetra shekujsh zbuloi sekretin e humanizmit. Ky sekret ka lidhje me popullin, me pronarët, me pushtetarët për të vënë peshoren e drejtësisë për popullin, sepse ky ka kontribuar që ata të ngjisin shkallët e pushtetit. Ai fshikulloi në kohët e hershme privimin e të mirave nga të gjithë njerëzit, ushtrimin e dhunës ndaj masës dhe gjithashtu tregoi me gisht faktorët e të keqes, të poshtërimit e mashtrimit që maskohen me petkun e pushtetit. Ky njeri i madh i kohërave çoi përpara të vërtetën e humanizmit, që është hyjnore, e vjetër që me fillimin e shoqërisë njerëzore dhe e qëndrueshme në përjetësi. Kjo e vërtetë vjen nga thellësia e absolute që përfaqëson sundimin e të vërtetës me të cilën duhet të

bashkohet zemra e mendja si dhe morali që dalin prej tyre. Çdo pohim për absoluten është fuqi dhe njeriu bëhet shembull i kësaj fuqie në jetën e tij, në fitoret e humbjet e tij. Në të gjitha gjendjet ai duket i barabartë, sepse ajo është këtu dhe atje, ajo është mposhtësja dominuese në të cilën janë të barabarta triumfi dhe disfata në fushën e betejës, në fushën e politikës e në të gjitha fushat e tjera. Në triumf e në disfatë për atë, nuk ka gur prove, sepse vetë ajo mban të gjitha përmasat. Por besimi i fortë në absoluten, Zotin e Plotfuqishëm, kalon çdo vështirësi, triumfi i tij është i sigurtë, sepse me të ai nuk bën pazare, nuk mashtron në zgjedhjen e preferuar.

Imam Aliu ishte ai që kuptoi shkaqet e dashurisë e të besës vetëm në kuadrin e njeriut me karakter të singertë, ku shpirti i rrjedh prej shpirtit. Për këtë arsye ai dashuron me tërë shpirtin e vet që ka marrë si obligim nga krijuesi i tij dhe i qëndron besnik atij. Ai në thellësinë e mendimit e të ndjenjave e kuptoi se liria është e shenjtë sepse atë e dëshiron vetë qenia. Për lirinë nuk mund të ketë zëvendësues dhe rreth saj vërtiten të gjitha mendimet e të gjitha ndjenjat. Për Imam Aliun, në kuadrin e lirisë janë të qarta e të lëvizshme dashuria dhe besa. Ai thotë: "Më i keqi i vëllezërve është ai që nuk e mban dot detyrimin me të cilin është ngarkuar dhe më i miri i tyre është ai që nuk është në këtë pozitë". Shqetësimi kryesor i tij ishte shpëtimi i të mjeruarëve, i të varfërve e të pafuqishmëve prej padrejtësive, t'i shpëtonte ata nga shfrytëzimi dhe të siguronte jetën e tyre për një jetë më të ndershme. Asnjëherë nuk u kujdes për jetën e tij që të ngopej, të pinte e të flinte i gëzuar kur mbi tokë, siç thoshte ai, kishte "barqe të uritur dhe zemra të zemëruara", pastaj vazhdonte: "A mund të jem unë i kënaqur të më thërrasin prijës i besimtarëve dhe të mos i shoqëroj ata në vështirësitë e kohës?". Ai nuk kishte kufi në ndihmë të së mirës dhe në sakrifica që gjenin në kryerjen e mrekullive. Gjithmonë ka qënë me të drejtën dhe të vërtetën dhe e ka zbatuar me korrektësinë më të madhe. Por drejtësia për të nuk ishte një rrugë e fituar edhe se në programin e punës së tij si kalif ka qënë rruga e vetme që ndiqte. E ndoqi këtë rrugë dhe arriti që ajo të zerë vend në zemrat e njerëzve të mirë. Drejtësia në aspektin e tij moral dhe edukativ ishte baza e bashkimit që nuk lejonte as veten as të tjerët të dilnin jashtë saj. Trupi i tij ishte mbrojtur nga drejtësia që qarkullonte në tërë gjakun dhe shpirtin e tij. Atë e luftuan, por u poshtëruan, sepse i ngritën kurthe e komplote me armiqtë, që përdorën mashtrimin e pazarllëkun, kompllotin për të fituar me shpatën e helmatisur. Në dritën e arsyes e të zemrës ai qëndroi i papërkulur në rrugën e tij. Rënia e dëshmuar e tij krijoi një atmosferë tensioni e rritje të vlerave

në rrugën e respektit për njeriun, për të drejtat e njeriut dhe në rrugën për afirmimin e qëllimeve më të larta të drejtësisë e të barazisë.

Imam Aliu mbeti në histori si luftëtar, trim mbi trimat, ku dashurinë për njeriun e shprehte edhe tek kundërshtarët e tij, me butësinë që e karakterizonte. Ai shprehej: "Mos filloni të luftoni derisa ata të fillojnë të parët dhe në se me lejen e Allahut do të shpartallohen, ju mos vrisni asnjë që i ka kthyer shpinën betejës, mos atakoni asnjë që është hequr mënjanë, mos shpejtoni të vrisni të plagosurit dhe mos mundoni e mos fyeri gratë". Mbetet reformatori më besnik dhe përmirësuesi më fisnik i ligjeve të luftës. Ai thotë: "Luftëtari që bie dëshmor në rrugën e Allahut, nuk ka shpërblim më të madh se sa atëhere kur fal atë që e ka në dorë, sikur ai i faluri të ishte njëri prej engjejve".

Gjenialiteti i tij u duk në fjalën e tij plot madhësi kur mbi të u ngrit dora vrasëse tradhëtare. Për vrasësin ai u shpreh: "Në se falni, është shumë më afër devotshmërisë". Në zemrën e tij ishin të bashkuara trimëria e rrallë me dashurinë e mahnitëshme në luftë me armiqtë e tij. Ai qante për ta, kur ata vazhdonin rrugën e armiqtësisë. Asnjëherë nuk e përdori shpatën i pari kundër tyre. Në triumf qan mbi të vararët e armiqtëve. Tek ai ishin të bashkuara të gjitha mirësitë e prioritetet e fisnikërisë në krye të pushtetit, por ai shprehej: "Nuk ka fisnikëri si kryeultësia". Dashamirësve të tij u thoshte: "Kush më do mua, le të përgatisë një rrobë për varfërinë". Pastaj i drejtohej vetes: "O Zoti im, fal mëkatet tona, përgjithçka ata nuk e dinë".

Imam Aliu është dijetari, mendimtari, letrari, administrator dhe sundimtari komandant që nuk lejoi komplotet e trillime në dëm të individëve të veçantë dhe shoqërisë. Ai thotë: "Fale atë që të ka bërë padrejtësi, jepi atij që nuk të ka dhënë, mbaji lidhjet me atë që i ka prerë lidhjet me ty dhe mos e urre atë që të urren ty". Historia ka vërtetuar se ai ka ndërgjegje kolosale, që me zërin e drejtësisë krijoi personalitetin e tij në historinë e islamit. Ai qëndroi në krye të kuvendit të njerëzve të urtë e të ditur, të njerëzve më të shquar të historisë. Kjo pati ndikimin më të lartë në orjentimin e traditës profetike e vulosjen e saj në karakterin e besimtarit islam.

Jo vetëm kaq, por Imam Aliu ka dhënë kontributin e tij edhe në fushën e mendimit filozofik për çështje të ndryshme të jetës, gjithësisë, shoqërisë njerëzore, çështjeve që kanë lidhje me Njësinë e Zotit, me adhurimet e tij etj. Ai është mësues i shkëlqyer dhe dallohej ndër ligjëruesit dhe mendimtarët e kohës. Si i tillë ai njihte mirë kufirin e lirisë e të të drejtave të njeriut. Ai shprehej: "Mos ji skllav e një tjetri, Allahu të ka bërë njeri të lirë".

Islami i tij ishte islami i njeriut, të cilit iu dha mundësia të formojë personalitetin e tij me dashurinë për të mirën e të rritet nën kujdesin e të dërguarit të Allahut, Muhamedit, Paqja e Bekimi i Zotit qoftë mbi të. Pas tij ai bëhet imami i të drejtave të besimtarëve, që luftoi për një shoqëri ku të mbizotëronte paqja e qetësia.

Për Imam Aliun këto fjalë që rreshtuam nuk e plotësojnë personalitetin e tij të madh, por po e mbyllim me letrën që i dërgon djalit të tij, Hasanit në betejën e Sifinit: Bir i dashur, bëje veten tënde peshore në punët që janë mes teje e njerëzve. Duaj për tjetrin, atë që do për veten tënde; gjithashtu urre për tjetrin atë çka urren për veten tënde. Mos bëj padrejtësi, ashtu siç nuk dëshiron të të bëhet padrejtësi, bëj mirë ashtu siç dëshiron të bëjnë mirë për ty. Atë çka e numëron të keqe për veten tënde, numëroje të keqe edhe për tjetrin. Dëshiro për njerëzit atë që dëshiron edhe për veten tënde, mos flit për gjëra që nuk ke dituri, madje mos flit as për gjëra për të cilat ke pak dituri dhe mos thuaj nga ato fjalë që nuk dëshiron të thuhet për ty. Kush mendon mirë për ty, vërtetoje mendimin e tij. Kurrë mos e humb të drejtën e vëllait tënd duke u bazuar mbi ato që mund të jenë mes teje dhe atij, sepse nuk është më vëllai yt ai që ti i humbe të drejtën e tij. Familja jote të mos jetë me ty ndër njerëzit më të këqinj, vëllai yt të jetë më i fuqishëm në ndërprerjen e lidhjeve me ty, nga ç'je ti në mbrojtjen e lidhjeve me të; gjithashtu ai të mos jetë më i fuqishëm se ti për të bërë keq nga ç'je ti për të bërë mirë". Pastaj ai shton: "O Zoti im, Zoti i kësaj Toke, të cilën ti e ke bërë vendqëndrim për njerëzit, vendqëndrim për insektet e kafshët dhe për të tjerë që nuk numërohen e prej atyre që nuk shihen me sy, largoje prej nesh të keqen dhe na drejto në të vërtetën". Edhe ne bashkohemi me lutjen e tij. Zoti e mëshiroftë! Amin!